



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	14.08.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 225/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr.69/2017 të dt. 28.07.2017 për lëndën Bardhyl Zajmi Nr. 04-353-75371 për mbindërtimin e katit të dytë në objektin – shtëpisë individuale me lokal, në ngastrën kadastrale Nr.01947-2-843-0 Z.K. Prizren.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



417

10.08.201

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 69/2017
Datë: 28.07.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: "Miratimi i projektit për ndërtimin e shtëpisë individuale për banim me lokal në ngastrën kadastrale Nr. 01947 – 2 843 – 0, Z.K.Prizren.
2. Në bazë të rekomandimit dhe arsytimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues i cili duhet të shqyrtohet dhe aprovohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e zyrtarëve profesional nga Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore –Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Bardhyl Zajmi nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për mbindërtim të katit të dytë të shtëpisë individuale për banim me lokal, për objektin i cili gjendet në parcelën kadastrale me Nr. 01947 – 2 – 843 – 0. Objekti ekzistues ka etazhitet P + 1, ndërsa me kërkesën për rindërtim ky etazhitet parashihet të jetë P + 2. Objekti gjendet në Zonën e VI – të sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, ku etazhiteti i lejuar është P+2 dhe lartësia maksimale deri te streha është 9.5 m, kurse për ndërtim mund të shfrytëzohet deri 60% të sipërfaqes së parcelës. Në afërsi të këtij objekti ekzistues gjendet shtëpia e familjes Myftiu, Xhamia e Emin Pashës dhe Hamami i Gazi Mehmet Pashës, objekte këto të cilat janë në listën e MKRS – së (Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme). Nga Komisioni kërkohet shqyrtimi i intervenimit dhe vlerësimi i përshtatshmërisë me kriteret për ndërtim në zonën e VI sipas Planit të Konservimit. Komisioni shqyrton dokumentacionin dhe aprovon projektin i cili është në përputhje me intervenimet e parapara për këtë zonë.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si në vijim:

1. Të aprovohet projekti ideor për mbindërtim të objektit – shtëpi individuale e banimit në parcelën kadastrale me Nr. 01947 – 2 – 843 – 0, me pronar Bardhyl Zajmi;
2. Informohet pala që lartësia e lejuar deri tek streha është 9.5m. Intervenimi bëhet edhe nën mbikëqyrjen e IKMM – së, përmes QRTK – Prizren.
3. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK – Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK – Prizren (një për QRTK – në dhe një për IKMM – në).

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM –së;
- Arkivit të IKMM –së;
- Arkivit të MKRS – së;

